



# Kodi i Etikës së Biznesit i ALBtelecom





## **Ky dokument është Kodi i Etikës së Biznesit i ALBtelecom sh.a.**

KODI I I ETIKËS SË BISNESIT I ALBtelecom është një përmbledhje e politikave dhe rregulloreve themelore të kompanisë të cilat rregullojnë marrëdhëniet tona mes njëri-tjetrit dhe me palët e intetesuara. Detaje të mëtejshme dhe rregulla shtesë për punonjësit e ALBtelecom në fusha të veçanta të veprimeve mund ti gjeni tek Dokumentat e Kompanisë<sup>1</sup>.

Dokumentacioni i Kompanisë mund të gjendet në faqen e intranetit:

<http://companydocuments/default.aspx>

---

<sup>1</sup> Dokumentacioni i Kompanisë do të thotë, duke përfshirë pa u kufizuar në procedurat, politikat, udhëzimet, manualët etj, qoftë në kopje fizike dhe / ose elektronike që janë lëshuar nga Kompania dhe që rregullojnë fusha ose veprimet e vecanta brenda ose jashtë Kompanisë, dhe/ose të palëve të treta, dhe amendimet dhe/ ose ndryshimet e tyre në kohë.

# 1. HYRJE NË PARIMET UDHËZUESE



Kodi i Etikës së Biznesit është kuadri dhe mjeti ynë udhëzues për ta ruajtur perceptimin mbi ALBtelecom-in si një partner i besuar, për ta drejtuar biznesin me përgjegjësi si dhe për të na kujtuar të gjithëve në ALBtelecom që **çdo veprim është i rëndësishëm**. Këto udhëzime janë themeli se si funksionon ALBtelecom, si dhe na ndihmojnë në ruajtjen e besueshmërisë dhe kredibilitetit me klientët tanë, partnerët, punonjësit, aksionerët tanë dhe me palët e tjera të interesuara.

Duke ndjekur këtë kuadër udhëzues ne mund ta arrijmë siç duhet misionin dhe vizionin e ALBtelecom, në mënyrë që ta bëjmë komunikimin sa më të thjeshtë në të gjitha drejtimet, si dhe të prezantojmë produkte inovative në të gjitha segmentet ku ne operojmë.

Si anëtarë të Çalik Group, ne i përmbahemi, besojmë dhe jemi të lidhur me vlerat themelore dhe parimet e biznesit të Grupit:

## Vlerat Themelore të Çalik Group:

1. **Paanësia** - ne veprojmë me ndjenjën e drejtësisë dhe paanësisë ;
2. **Etika** - ne kemi standarte të një morali të lartë;
2. **Reputacioni** - ne ruajmë reputacionin mbi cdo gjë tjetër;
3. **Respekti** – ne i shikojmë ndryshimet tona si pasuri dhe refuzojmë cdo formë diskriminimi;
4. **Solidariteti** - ne mbështesim gjithmonë njëri tjetrin;
5. **Fokusi Njerëzor** - ne besojmë që suksesi me njerëzit është i mundshëm dhe kuptimplotë.

## Parimet e Biznesit të Çalik Group:

1. **Vendosmëria** - ne punojmë shumë për atë që premtojmë;

2. **Kompetanca**- ne punjmë me njerëz kompetent
3. **Kuraja** – neve besojmë në vetvete dhe mund të jemi të besueshëm ;
4. **Konsultimi** – ne vlerësojmë idetë e ndryshme ;
5. **Fokusimi tek Klienti** - ne përqipemi të kuptojmë më mirë nevojat dhe pritshmëritë e klientëve tanë;
6. **Ndjenja e Përgjegjshmërisë** - ne ndjehemi përgjegjës për të mbrojtur dhe mbajtur lart vlerat e njerëzimit, shoqërisë dhe kompanisë sonë;

## **Veprimet me integritet, transparencë dhe përgjegjësi karakterizojnë rrugën që ALBtelecom drejton biznesin.**

Një kulturë integriteti është vendimtare për të ruajtur besimin dhe kredibilitetin me klientët tanë, partnerët, punonjësit, aksionerët si dhe me palët e tjera të interesuara. Në anën tjetër, ky besim dhe kredibilitet ka nevojë për **transparencë** dhe **konfidencialitet** në mënyrën se si ne drejtojmë biznesin me qëllim mbrojtjen e aseteve të biznesit dhe privatësinë e individëve.

Veprimi nëpërmjet një **sjellje etike biznesi** është një prioritet i lartë i ALBtelecom. Kodi ynë i Etikës së Biznesit është premtimi ynë për të vepruar me ndershmëri dhe vërtetësi në marrëdhëniet tona dhe komunikimin tonë me tregun.

**Ne presim që secili, nisur nga anëtarët e Këshillit të Admistrimit deri tek çdo individ që punon në /dhe për ALBtelecom, do të jetë përgjegjës për përmbushjen e këtyre standardeve si dhe do të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë Kod. Ky Kod zbatohet në mënyrë të njëjtë dhe ndaj konsulentëve dhe individëve puna e të cilëve është ekuivalente nga ana funksionale me atë të kryer nga punonjësit e kompanisë si psh punonjësit e nënkontraktorëve si dhe punonjësit me kontratë personale.**

**Të qënurit pjesë e ALBtelecom kërkon që çdo individ të pranojë përgjegjësinë.** Ne jemi të vetëdijshëm se çdo incident i vetëm i një sjelljeje të gabuar mund të dëmtojë jo vetëm suksesin tonë si individë, por edhe reputacionin e ALBtelecom dhe të Grupit Çalik Holding tek i cili bëjmë pjesë. Prandaj, çdo individ duhet të angazhohet në respektimin e këtij Kodi të Etikës së Biznesit duke kontribuar në **angazhimin e Kompanisë për drejtimin e biznesit në mënyrë të përgjegjshme**, duke përfshirë:

- Të qënurit qytetarë të përgjegjshëm të kompanisë;
- Respektimin e të drejtave të njeriut;
- Sigurimin e shëndetit dhe sigurisë;
- Inkurajimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Ky Kod përmban gjithashtu rregullat dhe udhëzimet për:


- Sigurimin që veprimet të përputhen në çdo kohë me ligjet, rregullat dhe rregulloret që aplikohen;
- Konfliktet e interes;
- Mbrojtjen dhe shfrytëzimin siç duhet të aseteve të kompanisë;
- Ruajtjen e informacionit;
- Komunikimin e jashtëm;
- Kërkimin e udhëzimeve dhe raportimin.

## 2. ANGAZHIMI I ALBtelecom NË DREJTIMIN ME PËRGJEGJËSI TË BIZNESIT



ALBtelecom ka si qëllim ofrimin e produkteve dhe shërbimeve që ecin paralel me **misionin e Kompanisë për kombinimin e teknologjisë me stilin e jetesës, për ta bërë jetën e njerëzve më të pasuruar dhe më të lehtë**. Një element kyç për të përmbushur këtë mision është **të vepruarit me përgjegjshmëri** në interesin më të mirë të Kompanisë kudo që ne bëjmë biznes duke ruajtur besimin e shoqërisë, klientëve dhe palëve të tjera të interesuara.

### 2.1 Detyrimi ynë si qytetarë të përgjegjshëm të kompanisë në komunitet



Është e rëndësishme që të sillemi në një mënyrë të përgjegjshme sociale dhe etike dhe duke besuar në këtë parim ne angazhohemi për të qënë qytetarë të përgjegjshëm në komunitetin ku ne kryejmë biznesin. Ne i japim rëndësi dëgjimit të shqetësimeve që mund të ketë komuniteti (përfshi këtu edhe klientët tanë), për shembull në lidhje me zgjerimin e rrjetit, çështjet e mjedisit, anti-korrupsionit etj. Ne jemi të prirur për të qënë gjithëpërfshirës dhe për të kërkuar përgjigje ndaj pyetjeve që komuniteti mund të ngrrejë,

dhe do të bëjmë më të mirën për të siguruar që shqetësimi i gjithsecilit të jetë marë në konsideratë. Është shumë e rëndësishme që markat ALBtelecom dhe Eagle Mobile të jenë gjithmonë të lidhura me respektimin e të drejtave të njeriut, mbrojtjen e mjedisit, dhe me kushte të drejta dhe të sigurta pune. Ky parim përbën bazën e përqasjes tonë në drejtimin e biznesit në mënyrë të përgjegjshme.

## 2.2 Respektimi i të drejtave të njeriut

Ne kemi përgjegjësinë **për të respektuar të drejtat e njeriut në të gjitha veprimet tona të biznesit**. Në çdo veprim biznesi apo marrëdhënie, ne punojmë për tu siguruar që ne nuk jemi të përfshirë në asnjë shkelje të drejtave të njeriut dhe ne gjithmonë kërkojnë mënyra për të nderuar dhe zbatuar parimet e të drejtave të njeriut.

## 2.3 Sigurimi i një mjedisi pune të shëndetshëm dhe të sigurt



Ne presim që secili në ALBtelecom të sillet në çdo kohë me një mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme, në mënyrë që të ruajë një kulturë të fortë të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ne angazhohemi në këtë parim duke promovuar ndërgjegjësimin, masat parandaluese dhe përkujdesjen.

Një sjellje e tillë kërkohet nga secili që punon sëbashku me ne në ALBtelecom, si klientët, furnitorët, nënkontraktorët tanë dhe palët e tjera të interesuara. Vetëm në këtë mënyrë ne mund të sigurojmë një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm. Ky angazhim mbështetet dhe demonstron fuqimisht nga një Sistem i tërë i **Shëndetit & Sigurisë në Punë** përbërë nga kontrole të dokumentuara menaxheriale si dhe duke ndërmarë veprimet e nevojshme lidhur me këtë sistem. Ne veprojmë si një punëdhënës i përgjegjshëm duke mbrojtur jetën dhe shëndetin e secilit që punon për ALBtelecom dhe duke mbrojtur interesin tregtar dhe markën e ALBtelecom dhe Eagle Mobile.

## 2.4 Inkurajimi i zhvillimit të qëndrueshëm



ALBtelecom është i angazhuar për zhvillimin dhe ofrimin e produkteve dhe shërbimeve me një zhvillim të shkëlqyer qëndrueshmërie, i cili është procesi i zhvillimit për përmbushjen e qëllimeve të zhvillimit njerëzor duke ruajtur aftësinë e sistemeve natyrore në vazhdimin e sigurimit të burimeve natyrore dhe shërbimeve të ekosistemit mbi të cilat varet ekonomia dhe shoqëria. Ne inkurajojmë qëndrueshmërinë, si një përfitim afatgjatë sociale, mundësi prosperiteti ekonomik dhe një mundësi për të përmirësuar performancën mjedisore. Në këtë

kuadër, ne do të punojmë vazhdimisht për të minimizuar ndikimet negative të veprimeve tona të biznesit dhe të për të maksimizuar ndikimet pozitive për zhvillimin të qëndrueshëm më të mirë të shoqërisë. Ne do të rrisim ndërgjegjësimin e qëndrueshmërisë të punonjësve dhe do të angazhohemi me palët e interesuara në aktivitete të mundshme që kanë ndikim pozitiv ekonomik, social dhe mjedisor në komunitet, biznes dhe shoqëri. Ne gjithashtu do të nxisim furnitorët tanë që të angazhohen në këto standarde qëndrueshmërie. Si pjesë e ALBtelecom ne të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm për problemet mjedisore që lidhen me aktivitetet tona të punës dhe t'i përmbahemi udhëzimeve të pajtueshmërisë mjedisore që ndikojnë në punën tonë.

Në rast se ju dyshoni për shkelje të ndonjë prej çështjeve të ngritura mbi mjedisin, shëndetin, sigurinë dhe të drejtat e njeriut, ju duhet të raportoni në pikat e kontaktit të paraqitura në Seksionin 8 si më poshtë.

### 3. PËRPUTHSHMËRIA ME LIGJET, RREGULLORET, RREGULLAT E KOMPANISË DHE STANDARTET



**Kuadri Ligjor dhe Rregullator, Standartet** - ALBtelecom është i angazhuar për respektimin e të gjithë kuadrit ligjor dhe rregullator, standarteve dhe principeve ligjore që aplikohen ndaj biznesit të tij, qofshin këto kombëtare apo ndërkombëtare. Prandaj, është nën përgjegjësinë tuaj (të punonjësve dhe të tjerëve ndaj të cilëve aplikohet ky Kod) për të punuar dhe për të kryer aktivitetet e biznesit në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, ose me ligjet dhe standartet e tjera të aplikueshme ndërkombëtare ku kompania jonë mund të objekt për përputhshmëri. Shkeljet e çdo ligji apo rregulloreje të aplikueshme mund të kenë pasoja serioze si për Kompaninë ashtu edhe për individët e përfshirë.

**Rregullat dhe Rregulloret e Kompanisë** - Ne i konsiderojmë politikat, procedurat dhe rregulloret e Kompanisë sonë gjithashtu si instrumente të rëndësishme për drejtimin e biznesit në formën e duhur, si dhe për sjelljen sipas mënyrave të pranueshme etike. Të gjithë punonjësit duhet të lexojnë dhe respektojnë çdo politikë dhe procedurë/ rregullore të përcaktuar nga Kompania. Këto politika/ procedura/ rregullore janë objekt i ndryshimeve/ përditësimeve sipas nevojave të Kompanisë, prandaj çdo punonjës duhet të sigurohet për ndjekjen e çdo ndryshimi të publikuar nëpërmjet komunikimit të brendshëm dhe/ ose publikuar në faqen tonë të intranetit nën seksionin **"Dokumentacioni i Kompanisë"**. **Sistemi Menaxhimit të Cilësisë** në ALBtelecom siguron që secili prej jush të jetë i trajnuar siç duhet dhe në dijeni të dokumentacionit të kompanisë i cili mbulon çdo veprim pune që kryhet në ALBtelecom.

**Mbrojtja e Informacionit Personal** - ALBtelecom është i angazhuar për të mbrojtur

privatësinë e informacionit personal, duke përfshirë të dhënat personale në lidhje me klientët, punonjësit, partnerët e biznesit apo të fuqisë së jashtme punëtore. Ne ndjekim dhe respektojmë ligjet dhe rregulloret përkatëse që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale. Në rast se ju jeni i përfshirë në aksesimin ose procesimin e informacionit personal në veprimet e punës tuaj në ALBtelecom, ju duhet të jeni i vetëdijshëm dhe në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore dhe kontraktuale në fuqi.

**Raportimi Kontabël dhe Financiar** - ALBtelecom është i angazhuar për të ndjekur parimet dhe standardet rigoroze të raportimit të informacionit financiar në mënyrë të saktë dhe të plotë, si dhe të ketë kontrollet dhe proceset e duhura të brendshme për të siguruar se raportimi i kontabël dhe ai financiar janë në përputhje me kërkesat e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Si pjesë e ALBtelecom dhe si pjesë e këtij angazhimi, ju duhet të jepni mbështetjen tuaj për Kompaninë në këtë fushë.

**Konkurrenca** - Konkurrenca e drejtë dhe e hapur është baza për zhvillimin e biznesit dhe inovacionit për ALBtelecom, kështu që të gjithë ata që punojnë për ALBtelecom duhet të kryejnë punën e tyre dhe të sillen në mënyrë energjike dhe konstruktive duke respektuar ligjet në fuqi të konkurrencës.

Në këtë kuadër, një vëmendje e veçantë i është dhënë mbrojtjes së konkurrencës së hapur dhe të lirë në të gjitha marrëveshjet dhe marrëdhëniet tona të biznesit me palët e treta, veçanarisht për marrëveshjet me konkurrentët ose partnerët e biznesit. Propagandimi i informacionit të rremë rreth konkurrentëve dhe spiunazhi industrial janë rreptësisht të ndaluara. Duke besuar në konkurrencën e drejtë dhe të hapur, të gjithë ata që punojnë për ALBtelecom nuk do të kërkojnë, pranojnë ose të diskutojnë mbi informacion konfidencial apo qoftë dhe "informacionin të brendshëm" (informacion jopublik) të ALBtelecom me konkurrentët ose me palët e tjera të paautorizuara.

Në rast të ndonjë pasigurie në lidhje me kuadrin ligjor dhe rregullator, ju lutem mos hezitoni që të adresoni shqetësimin tuaj pranë Grupit tone Ligjor, Rregullator dhe të Konkurrencës për çdo këshillë/ ndihmë.



## 4. KONFLIKTET E INTERESIT



Të gjithë ne duhet të marrin vendime biznesi bazuar në interesin më të mirë të ALBtelecom dhe jo duke u bazuar në konsiderata dhe marrëdhënie personale. Një konflikt interesi lind kur diçka ndikon ose influencon në ushtrimin e gjykimit tonë të pavarur në interesin më të mirë të ALBtelecom. Në mënyrë që të bëjmë biznes në një mënyrë etike dhe në përputhje me këtë Kod, ne të gjithë duhet të shmangim situatat të cilat mund të çojnë interesin tonë personal në konflikt ose madje duke shfaqur konflikt me interesat e ALBtelecom. Shembuj të konflikteve të interesit përfshijnë por nuk janë të kufizuara me si më poshtë vijon:

**Dypunësim dhe marrëdhënie të tjera biznesi** - Ju nuk duhet të punësoheni jashtë ALBtelecom me ose pa kompensim nëse ky punësim dëmton apo mund të dëmtojë performancën tuaj të punës në ALBtelecom dhe/ose të krijojë / mund të krijojë një konflikt interesi.

Punonjësit e ALBtelecom nuk duhet të angazhohen në interesa biznesi jashtë ALBtelecom të cilat devijojnë kohën dhe vëmendjen nga përgjegjësitë e caktuara nga ALBtelecom ose kërkojnë punë gjatë orarit zyrtar të punës në ALBtelecom.

Dypunësimi nga një klient, furnitor ose konkurrent i Kompanisë është rreptësisht i ndaluar. Sigurimi i punës ose marrëdhëniet e biznesit në emër të Kompanisë ndaj një biznesi tjetër në të cilin ju keni një interes personal financiar konsiderohet gjithashtu si një konflikt interesi dhe është i ndaluar. Shfrytëzimi i mundësive të biznesit për veten tuaj të cilat janë identifikuar brenda detyrave/ përgjegjësisve tuaja në ALBtelecom mund të çojnë në situata në kundërshtim me interesin e ALBtelecom. Në këtë kuadër, shfrytëzimi i mundësive të tilla biznesi mund të çojnë në shfrytëzimin e pronës së ALBtelecom, informacionit të Kompanisë, ose pozicionit tuaj për përfitime personale.

Duke pasur interesa financiare ose marrëdhënie biznesi me një biznes që është konkurrent,

kontraktor ose furnitor i Kompanisë tonë, konsiderohet si konflikt interesi dhe si i tillë është i ndaluar.

Në rast se ju besoni se dypunësimi juaj i kërkuar nuk i përket asnjërës nga situatat e mësipërme, atëherë ju duhet të kërkonit miratimin nga Divizioni i Burimeve Njerëzore të ALBtelecom duke ndjekur politikat dhe procedurat përkatëse të brendshme të Kompanisë dhe vetëm pas miratimit ju mund të vazhdoni dhënien e kontributit tuaj për një vend tjetër të dytë pune.

**Punësimi i të afërmeve** - ALBtelecom pranon faktin se punësimi i anëtarëve të së njëjtës familje, sidomos në të njëjtin ekip apo devizion, mund të çojë në një konflikt interesi. Për të parandaluar që të lindin situata të tilla, ne nuk punësojnë të afërm të punonjësve aktualë. Personat të cilët janë të afërm të shkallës së parë me njëri-tjetrin nuk mund të punësohen në të njëjtën kompani. Në rast praktike të kundërt, miratimi duhet të merret nga to menaxhimi i Kompanisë pas vlerësimit të arsyeve të vlefshme.

**Përfshirja në Politikë** - Kushdo që punon për ALBtelecom ndalohet të japë kontribute politike qofshin këto direkte apo indirekte si dhe të mbështesë ndonjë parti politike, kandidat apo çështje në emër të Kompanisë. Shfrytëzimi i burimeve të ALBtelecom të tilla si koha, pajisje, mbështetje monetare, pronë ose markë/markat për aktivitete politike mund të shkaktojnë konflikt interesi dhe si e tillë duhet të evitohet. Çdo punonjës mund të angazhohet në veprimtari ose aktivitete politike gjatë kohës së tij të lirë para dhe pas punës, gjatë pushimeve dhe lejes së miratuar.

**Përdorimi privat i aseteve/bazës materiale të Kompanisë** - Me qëllim parandalimin e konfliktit të interesit, të gjithë ata që punojnë për ALBtelecom nuk u lejohet që të përdorin për nevoja private asete apo baze materiale të kompanisë përveçëse në rastet kur është e parashikuar ndryshe tek të drejtat individuale shprehur në marrëveshjet kolektive, në marrëveshjet individuale ose tek procedurat dhe rregulloret e brendshme të Kompanisë.

**Evidentimi i konfliktit të interesit** - ALBtelecom kërkon nga ana juaj që të tregoni paraprakisht veprime ose situata të cilat pritet/gjykohet që mund të përbëjnë një konflikt interesi. Pas dhënies së këtij informacioni tek Divizioni i Burimeve Njerëzore, Divizioni i Çështjeve Ligjore dhe Skuadrës së Performances & Projekteve të Kompanisë, ju do të njoftoheni nëse ka një konflikt interesi dhe nëse po, si mund të zgjidhet më mirë.

## 5. MBROJTJA DHE PËRDORIMI I DUHUR I ASETVE TË KOMPANISË



Çdo lloj aseti që është në pronësinë e ALBtelecom mund të jetë i rëndësishëm në operimin siç duhet të Kompanisë. Asete të tilla mund të jenë **asete fizike**, **burime të IT-së**, apo dhe **asete të pronësisë intelektuale të Kompanisë** në formën e shpikjeve, sekreteve tregtare, ideve, etj. Gjithashtu secila prej tyre mund të përmbajë **informacion në pronësi** të ALBtelecom.

Informacioni në pronësisë të Kompanisë ruhet me një konfidencialitet të striktë dhe nuk zbulohet/nxirret, përdoret, deklarohet, ose publikohet përveç rasteve kur ky zbulim/nxjerrje, përdorim ose publikim i informacionit nevojitet për nevojat e punës suaj për Kompaninë, ose nëse një Titullar Ekzekutiv i Kompanisë autorizon shprehimisht me shkrim diçka të tillë.

Secili prej jush është përgjegjës për mbrojtjen e pronësisë së ALBtelecom që ju është besuar juve, dhe se është gjithashtu secili prej jush është përgjegjës për të ndihmuar në mbrojtjen e gjithë aseteve të kompanisë në përgjithësi. Në mënyrë që ta kryeni sç duhet diçka të tillë, juve duhet të jeni në njohuri të të gjitha politikave dhe procedurave të sigurisë mbi informacionin e brendshëm dhe ta raportoni çdo humbje, rrezik ose humbje të pasurisë së ALBtelecom sa më shpejt që ti vëreni ato. Është në përgjegjësinë e çdo punonjësi të ALBtelecom që t'i përmbahet politikave të ALBtelecom lidhur me sigurinë e informacionit dhe të operojë në përputhje me Marrëveshjen Inviduale të Konfidencialitetit<sup>1</sup>.

**Përdorimi i burimeve të IT-së të ALBtelecom** – Burimet e IT-së të ALBtelecom duke përfshirë sistemet e komunikimit, pajisjet e IT-së dhe lidhjet me internetin, duhet të përdorën vetëm për kryerjen e operacioneve të biznesit të ALBtelecom-it ose për qëllime të tjera të autorizuara nga menaxhimi i lartë i Kompanisë ose nga procedurat përkatëse të brendshme të Kompanisë. Kompania siguron të gjitha pajisjet e nevojshme për punonjësit për të kryer punën e tyre dhe për këtë arsye ju nuk mund të sillni kompjutera personale në vendin e punës dhe për më tepër nuk mund ti lidhni ata me rrjetin ose me sistemet e kompanisë, përveç nëse lejohet nga kompania për një veprim të tillë. Në rast se pajisjet personale janë sjellë në vendin e punës, atëherë kompania rezervon të drejtën e inspektimit të pajisjeve të tilla. Përdorimi i palejuar i burimeve të IT-së së ALBtelecom përfshin: përpunimin, dërgimin, nxjerrjen, aksesimin, shfaqjen, ruajtjen, printimin ose shpërndarjen e materialeve dhe informacioneve të cilat janë konfidenciale, mashtruese, ngacmuese, kërcënuese, të paligjshme, racore, frikësuese, shpifëse ose në kundërshtim me një mjedis profesional.

**Kur ndërpriten marrëdhëniet e tua të punës** – Ju duhet të ktheni të gjitha asetet e Kompanisë që janë në dispozicionin tuaj, duke përfshirë këtu të gjitha informacionet në pronësi të Kompanisë që janë në dispozicionin tuaj duke zbatuar Marrëveshjen e Konfidencialitetit. Ju mbeteni të lidhur me detyrime për kufizimin në përdorim/njerrje dhe publikim të informacionit në pronësi të ALBtelecom qoftë dhe pas largimit nga ALBtelecom.

---

<sup>1</sup> **Marrëveshja e Konfidencialitetit** është një marrëveshje që punonjësi nënshkruan në momentin kur punësohet në ALBtelecom. Kjo marrëveshje rregullon përdorimin dhe mbrojtjen e informacionit konfidencial të Kompanisë nga punonjësi

## 6. MBROJTJA E INFORMACIONIT



Ne të gjithë duhet të bashkëpunojnë në mënyrë që informacioni ynë të mos ekspozohet/nxirret tek persona të paautorizuar. Është detyrë e secilit prej nesh që të mbrojmë asetet e informacionit të ALBtelecom si dhe ato të klientëve tanë, investorëve, partnerëve dhe furnitorëve. Ruajtja e sigurisë së informacionit mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në suksesin e ALBtelecom dhe imazhin e tij në treg. Për këtë arsye ne kemi krijuar një sistem të mirëstrukturuar të **Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit** me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe të duhura teknike dhe organizative me qëllim parandalimin e humbjeve, aksesit të paautorizuar, ndryshimit dhe fshirjen e informacionit të paautorizuar mbi asetet e kompanisë, klientëve, ose informacionit mbi asetet e palëve të treta.

ALBtelecom është **i angazhuar** për të punuar ngushtë me klientët e tij, punonjësit, palët e interesuara dhe me organet rregullatore për të zhvilluar dhe për të përmirësuar këtë sistem. Si pjesë e këtij angazhimi, ne synojmë:

- Përdorimin e trajnimeve dhe komunikimit me të gjithë punonjësit për të siguruar njohurinë e duhur mbi Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit;
- Krijimin e kulturës së Sigurisë së Informacionit në ALBtelecom, si një angazhim afat-gjatë;
- Garantimin e sigurisë së duhur, konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit;
- Mbrojtjen e sigurisë së informacionit mbi asetet tona përmes menaxhimit efektiv të vazhdimësisë së biznesit;
- Garantimin që çdo shkelje dhe incidente të sigurisë së informacionit është raportuar dhe ndjekur siç duhet;
- Garantimin që ne kuptojmë dhe jemi në përputhshmeri me kërkesat përkatëse ligjore dhe rregullatore në lidhje me sigurinë e informacionit;

## 7. KOMUNIKIMI I JASHTËM



### 7.1 Komunikimi me mediat dhe palët e treta jashtë Kompanisë



ALBtelecom synon të arrijë standarde të larta komunikimi, duke i siguruar marrësve të informacionit (palëve të interesuara) në mënyrë të pranueshme dhe të kuptueshme informacion të vërtetë dhe të verifikuar nga përfaqësuesit e caktuar të tij. ALBtelecom i përgjigjet të gjitha pyetjeve të bëra nga palët e interesuara lidhur me ALBtelecom dhe aktivitetet e tij përmes një qëndrim zyrtar të kompanisë, ose një personi të autorizuar për komunikimin me jashtë. Kështu që juve nuk jeni i autorizuar për të komunikuar në emër të ALBtelecom

përveç nëse parashikohet në përgjegjësitë e pozicionit tuaj të punës një veprim i tillë. Çdo informacion për komunikim me jashtë duhet të miratohet nga Divizioni i Marrëdhënieve me Publikun. Ky Divizion siguron shpërndarjen në kohë të informacionit në rast të kërkesës nga palët e jashtme ose në rast nevojë të identifikuar nga Kompania për komunikim me palët e jashtme.

### 7.2 Komunikimi në Mediat Sociale




**Media Sociale Zyrtare e ALBtelecom** – Çdo llogari zyrtare e ALBtelecom e hapur në mediat sociale kontribuon në zhvillimin e imazhit të kompanisë. Menaxhimi i llogarive zyrtare të medias sociale si Facebook, YouTube, LinkedIn, Twitter dhe Instagram etj, kryhet vetëm nga Divizione të caktuara në Kompani.

**Përdorimi Personal i Medias Sociale** - Ne respektojmë të drejtën e punonjësve për të përdorur llogaritë personale të

mediave sociale, por gjatë përdorimit të këtyre llogarive për të përmendur informacione në lidhje me ALBtelecom ju duhet të keni parasysh që secili nga ju është ambasador i imazhit dhe markës së Kompanisë tonë. Kështu që, ne presim që secili të silltet në mënyrë profesionale, të ruajë konfidencialitetin, dhe të mos bëjë deklarata që mund të keqinterpretohen dhe që mund të kenë ndikim negativ në ALBtelecom. Secili prej jush është përgjegjës për tu siguruar që përdorimi ynë i mediave sociale është në përputhje me këtë Kod, me parimet e kompanisë dhe me Politikën e Sigurisë së Informacionit. Ne duhet të kemi gjithmonë parasysh se ajo që themi dhe menyra si e themi mund të ndikojë në mënyrën se si perceptohet Kompania.

## 8. KËRKIMI I UDHËZIMIT DHE RAPORTIMI



Duke ndarë me ne pyetjet si dhe me raportimin e shqetësimeve tuaja dhe/ose shkeljeve të këtij Kodi, ne mund të afirmojmë Vlerat e ALBtelecom dhe angazhimin e Kompanisë sonë ndaj integritetit, ndershmërisë dhe biznesit etik. Përveç kësaj, ne kontribuojmë në kulturën tonë të përbashkët të biznesit dhe lejojmë trajtimin e problemeve aktuale përpara se ato të bëhen çështje madhore për Kompaninë. Duke ngritur zërin, ne angazhohemi që të përmirësojmë vazhdimisht mënyrën sesi ne drejtojmë biznesin tonë. Nëse dëshironi të raportoni një shkelje, të ndani një pyetje ose shqetësim ju jeni të inkurajuar të:

- Flisni ose raportoni tek supërvizorët tuaj;
- Raportoni dhe të konsultoheni me Divizionin e Çështjeve Ligjore, Divizionin e Burimeve Njerëzore dhe/ose Skuadrën e Performancës së Kompanisë;
- Raportoni rastin via email [reporting.violations@albtelecom.al](mailto:reporting.violations@albtelecom.al) ;
- Raportoni rastin zyrtarisht nëpërmjet postës në adresën e ALBtelecom: *ALBtelecom & Eagle Mobile Autostrada Tirane-Durres, Km 7, Kashar*